

lajmi.net

Dogana jep detaje për ndalimin e zyrtarit të Ministrisë së Infrastrukturës, të cilit iu kapën katër mijë fishekë



09/06/2022 15:40

f

t

l

Oficerët doganor kanë parandaluar sot futjen ilegale të 4000 copë fishekve në pikëkalimin kufitar të Jarinjës.

Sipas doganës, gjatë kontrolleve rutinore të automjeteve në hyrje, në një automjet me targa të Serbisë oficerët kanë gjetur të fshehura në bagazh municione, menjëherë në bashkëpunim me policinë e Kosovë është bërë arrestimi i drejtuesit të makinës.

“Kontrolli detal ka zbuluar municion si në vijim 39 pako x 50 copë të llojit AUTO FMT 71gr/4.6gr gjithsej 1950 cope, 41 pako x 50 copë të llojit 9mm LUGER FMJ 124gr/8.0gr gjithsej 2050 cope. Gjithsejtë 4000 copë. Rasti i është dorëzuar Policisë së Kosovës për hetime të mëtejme”, thuhet në njoftim.

Dogana e Kosovës thotë se në bashkëpunim me autoritetet kompetente do të vazhdojë të ushtroj kontrolla në kuadër të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi të saj, me qëllimin e vetëm parandalimin e veprimtarive ilegale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

LAJME TË FUNDIT

- Muriqiiiiiiiiiiii! Kosova avancon ndaj Irlandës së Veriut
- Presidentja Osmani udhëton për në Greqi për Samitin...
- NIMI TV SJELL LOJËN E MADHE SHPËRBLYESE DUKE...
- Publikohet bashkëpunimi në mes Noizyt dhe Yll Limanit

Artikuj të ngjashëm

June 9, 2022

Presidentja Osmani udhëton për në Greqi për Samitin e vendeve të...

June 9, 2022

NIMI TV SJELL LOJËN E MADHE SHPËRBLYESE DUKE DHURUAR 5 VETURA...

June 9, 2022

“Bartësit e institucioneve nuk duhet të kenë frikë”, Çitaku kritikon Kurtin...

June 9, 2022

Musliu i kundërpërgjigjet Sveçlës, pas deklaratave për veteranët: Kjo është tallje...

June 9, 2022

Murati demanton Kurtin: Je në marrëdhënie pune, nuk ke si e...

June 9, 2022

Lame: Kush gëzohet që Thaçi është në burg, është antishqiptar